



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Debat me Publikun

01Nr 06-12473 /23

Klinë, dt: 07.04 /23

PROCESVERBAL

Nga Debatimi me Publikun, mbajtur, më 28.03.2023, me fillim nga ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, ku të pranishëm ishin anëtarë të KPF-së, drejtorë të drejtorive, zyrtarë tjerë komunal, drejtori i OSBE-së dhe qytetarë të Komunës së Klinës.

RENDI I DITËS

1. Draft-Rregullorja komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës,
2. Draft- Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027.

Fadil Gashi, kryesues: Po besoj që e keni marr edhe materialin, ne e kemi filluar këtë procedurë me gjitha mundësitë ligjore, konsultimet paraprake, me të gjitha institucionet relevante që operojnë në komunën e Klinës, kemi ardhur sot deri këtu dhe jemi bashkë me ju, që po kërkoj edhe ndihmën e juaj. Janë dy dokumente jashtëzakonisht të rëndësishme që prekin qytetarët tanë, prekin amvisërinë, bizneset, institucionet tona komunale, prandaj kemi nevojë sot me marr edhe nga ju sugjerime edhe vërejte, gjithçka që keni sot edhe ne e kemi seancën e Kuvendit të premtën, ku del për shqyrtim dhe miratim, prandaj edhe njëherë po ju falënderoj, dhe fillimisht po kaloj te zyrtarët e komunës, në këtë rast, Dardan Bashota, që të fillojmë të procedojmë me dokumentin e parë me draft -rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës. Urdhëro, z. Bashota?

Dardan Bashota, zyrtar mjedisor: Përshëndetje për ju kryesues, përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit, mirë se keni ardhur në këtë dëgjim publik! Siç e tha edhe kryesuesi është me një rëndësi të veçantë në komunën tonë. Draft-rregullorja komunale për menaxhim të mbeturinave, si pikësynim e ka rregullimin e transportimit, mirëmbajtjes si dhe grumbullimin dhe shërbimin e mbeturinave. Fillimisht kryetari i komunës ka bërë një komision prej pesë anëtarëve nën udhëheqjen e drejtorit të Shërbimeve Publike dhe ka filluar puna sipas kësaj rregulloreje. Kjo rregullore komunale, si bazë e ka Ligjin për Mbeturina, dmth bazamenti për rregullore është Ligji për Mbeturina, pastaj Ligji për Vetëqeverisje Lokale si dhe Ligjet e tjera të cilat janë të aplikueshme për mirëmbajtjen e kësaj rregullore.

Ne si njësi e menaxhimit të mbeturinave në komunën e Klinës, kemi filluar në punimin e kësaj rregulloreje duke e marr për bazë edhe rregulloren e kaluar dhe kemi bërë disa ndryshime në këtë rregullore aktuale, duke u bazuar edhe në inflacionin dhe gjendjen aktuale në komunën e Klinës. Çka është e rëndësishme në këtë rregullore, janë disa nene ose disa paragrafë të cilat janë specifike në këtë rregullore, siç është mënyra e tarifimit, pak a shumë ka ndryshuar tek kategorizimi i konsumatorëve dhe caktimi i tarifave për menaxhimin e mbeturinave, ata janë të përcaktuara me kategorizim. Pastaj kemi bërë disa ndryshime edhe tek riorganizimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, se konkretisht në komunën tonë tash grumbullimi dhe transportimi konkretisht i mbeturinave komunale, më së shumti të amvisërisë por edhe të bizneseve të tjerëve, po ashtu në këtë Rregullore specifikohet edhe mënyra e informimit, promovimit dhe raporti i menaxhimit të mbeturinave e cila do të bëhet në Kuvendin e komunës. Po ashtu, nën patronatin e kryetarit të komunës do të organizohen edhe ditët e pastrimit të komunës, i cili do të jetë me vendim të kryetarit të komunës. Po specifikohet gjithashtu edhe një bashkëpunim ndërkomunal nëse kemi interes që dy komuna fqinje p.sh., ne dhe Istogu që të kryejmë një deponi të inerteve së bashku me komunën e Istogut dhe shumë gjëra të tjera të cilat janë bërë në nenet e kësaj rregulloreje. Këtu parashihet edhe inspektimi që është shumë me rëndësi, ato hedhëset e mbeturinave që të inspektohen nga ana e Inspektoratit komunal dhe ato do të ndëshkohen në bazë të Ligjit të Mbeturinave, neni 71 dhe 73. Gjithashtu çka është me rëndësi në këtë dëgjim publik të ceket që, është edhe procedura e ankesës të cilët qytetarët kanë të drejtë të bëjnë ankesë pranë organeve të Inspektoratit komunal apo tek Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe të gjithë hedhësit e mbeturinave të cilët hedhin mbeturina jashtë kondiktave të cilat i ka përcaktuar komuna, e cila do të kryejë shërbimin e këtyre mbeturinave përmes kompanisë KRM “Ambienti”.

Atëherë do të merren në shqyrtim këto ankesa dhe do të gjobiten nëse ka bazë ndaj Inspektoratit komunal, nëse hedhësit e mbeturinave bëjnë shkelje, gjithashtu ngritja parashihet edhe regjistrimi i deponive ilegale. Ne prej vitit 2018 e kemi filluar regjistrimin e deponive ilegale për çdo vit, vazhdojmë të bëjmë identifikimin e deponive ilegale dhe largimin e disa deponive ilegale në disa pjesë të qytetit në territorin e komunës. Mirëpo, ata qytetarë të cilët shohin deponi ilegale të cilat janë krijuar, mund të raportojnë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në Inspektoratin komunal apo edhe në platformën *ndreqe.com* dhe ne do t'i marrim hapat që t'i largojmë këto deponi ilegale. Gjithashtu, Administrata komunale është e obliguar që pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore të marrin masa drejt zbatimit më rigoroz të kësaj rregullore dhe të kryejnë të gjitha përgjegjësitë që i kanë si Administratë komunale.

Në pika të shkurtra, ju besoj që e keni lexuar atë rregullore dhe jemi të gatshëm për ndonjë

pyetje, sugjerim apo koment nga ana juaj, faleminderit shumë!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, Dardan! Tani po hap debat për ju të pranishëm dhe po ju lus që të jeni pjesë e debatit. Janë dy dokumente të rëndësishme, prandaj kërkoj angazhimin e juaj dhe jo vetëm sot po edhe këto ditë që na kanë mbetur deri në seancë, ju keni edhe përmes adresës elektronike, edhe përmes zyrës së shërbimit, edhe nëse keni ndonjë propozim, ndonjë vërejtje, ndonjë sugjerim, ende keni kohë. Është një Rregullore që përbëhet prej 12 kapitujve, 47 neneve që u detajizuan edhe nga Dardani, prandaj ju i shini mundësitë e kyçjes suaj në cilëndo pjesë të kësaj rregullore, kudo që mundeni me dhanë kontributin e juaj, a ka dikush? Unë nuk po dyshoj se dokumenti nuk është i mirë, se është jashtëzakonisht i mirë, po ende kemi nevojë që të na ndihmoni edhe ju. Urdhëro, Ragip Kryeziu?

Ragip Kryeziu: Përshëndetje të gjithëve në këtë seancë kaq të mirë! Për temën e ambientit pak me vonesë po më duket ky debat se 23 vite pas lufte është shumë vonë, por kisha me pyet si mund t'i pastroj këto vende çka kanë mbetur, se ka mbeturina shumë, edhe kanalizimet krejt janë...a ka shpresë se hiqen ndonjëherë e bëhen impiantet? Ai vend se caktohet është mirë me ditë ku po caktohet, se më të vërtet janë bërë shumë mbeturina. Ka rëndësi të madhe të bëhet ndonjë vend që duhet, se atje në Pejë fort është ngarkuar, tash edhe një vend tjetër me bërë ashtu. S'di ka duam të shkojmë, edhe dënime kush gjuan vend e pavend, vyen pak me qenë më serioz, e jo nëse shkojmë publiku lajmërohet për diçka, edhe më inati ja marrin inspektorat se tregon një rast se sa ai se... pak me qenë më të angazhuar, me rregulluar përnjëmend, me u angazhuar të gjithë edhe me bërë sa më mirë.

Shpresoj të kemi sukses e vetëdijesohemi pak, më shumë s'kam çka të them!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, Ragip edhe për angazhimet tjera! Jo veç sot, por ne jemi për një çështje që jemi të gjithë kontribuues sepse të gjithë krijojmë mbeturina, është një institucion publik se i grumbullon edhe na i pastron. Prandaj nëse s'bëhemi bashkë të gjithë, ambientin s'mundet me mbajt pastër vetëm njëra palë, të gjithë bashkë, e dyta nuk jemi vonë sepse ne kemi pasur rregullore, ne kemi rregullore në fuqi, po kjo është një rregullore e re që i ndryshon ato të parat, duke u munduar me iu përfaruar sa më shumë realiteteve tona, edhe mjedisore, edhe institucionale, edhe në kuptimin buxhetor dhe gjithçka tjetër. Prandaj është e nevojshme me u ndryshuar sepse në rregullore edhe këso dokumente kemi. Po, urdhëro, Idriz Beqiri?

Idriz Beqiri, drejtor i kompanisë "Ambienti": Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje kryesues dhe gjithë pjesëmarrësit që janë në këtë dëgjim publik! Në radhë të parë, në emër të KRM "Ambienti", njësia Klinë, do t'i falënderoj komunën për bashkëpunimin e mirë që kemi pasur deri më tash. Shpresojmë dhe jemi në gjendje që prapë të vazhdojmë të njëjtin bashkëpunim, edhe të jemi në detyrat dhe përgjegjësitë që i kemi ne, konkretisht transmetimin dhe grumbullimin e mbeturinave dhe dërgimin e tyre deri në deponitë e caktuara, ta kryejmë me përkushtim dhe përgjegjësi. Po edhe unë i bashkëngjitna edhe apelit, edhe të Dardanit, edhe të kryesuesit, që realisht të gjithë së bashku mundemi me qenë mirë edhe me funksionuar në kuptimin e mirë që të kemi një qytet të pastër, duke u bazuar edhe në rregulloren që e kemi edhe në atë që e kemi pasur paraprake. Të gjitha janë të pozicionuara dhe të rregulluara në këtë

rregullore, që çdo qytetar i këtij vendi i komunës sonë, konkretisht është në gjitha instancat që është e mbrojtur edhe e ka adresën ku duhet të adresohet, edhe në rast që shohin që hedhet ndonjë mbeturinë në vend të pacaktuar, janë organet e caktuara me njerëz kompetent, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Inspektorati, që ne i jemi falënderues të gjithë dikastereve të komunës edhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Inspektoratit, të gjithë me radhë, që e kemi pasur një bashkëpunim të mirë edhe shpresojmë të kemi prapë një bashkëpunim të mirë.

Të gjithë së bashku ta duam Klinën më shumë edhe ta duam një Klinikë të pastër. Ju faleminderit edhe shpresojmë që kemi me qenë me një bashkëpunim të mirë të mundshëm, në gjitha mundësitë dhe kapacitete tona, që i kemi.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit kryesues, urdhëro i nderuar?

Drilon Morina, zyrtar për tatim në pronë: Këtu e pata një pyetje, në mungesë të dokumentit që nuk e kam parë, desha të pyes nëse është paraparë nëpër fshatra, përveç se nëpër shtëpia i kemi të gjithë kontejnerët, a është paraparë që në fshat të ketë kontejnerë të mëdhenj ku mund t'i hedhim mbeturinat? Se nëse ndalet dikush rrugës, ne e dimë se e ndal dikush veturën dhe i hedh nëpër rrugë. A është paraparë ndonjë kontejner i veçantë nëpër fshatra, së nëpër shtëpia i kemi gjithë, edhe në qytet e dimë po nëpër fshatra ndonjë të veçantë, të madh?

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit i nderuar, po, urdhëro, Dardan?

Dardan Bashota, zyrtar mjedisor: Përshëndetje, tek çështja e deponisë që e përmendi z. Ragipi, deponi komunale nuk mund të ketë, ligji i specifikon këto gjëra. Atëherë kemi vetëm deponi regjionale, dmth ajo që është aktuale, që është në Sferkë të thatë të Pejës. Nuk mund të kenë me ligj deponi legale komunale, se ligji e specifikon shumë çartë këtë, tek çështja e kontejnerëve, kontejnerët familjar ose kontejnerët 120 litërsh janë treguar më efikas, është një studim që është bërë nga GIZI gjerman dhe nga organizata tjera. Po ashtu, edhe kompania e cila bën grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave e thekson këtë gjë që, kontejnerët 120 litërsh janë më efikas të përdorshëm, po me kërkesën e banorëve, ne do ta shqyrtojmë kërkesën e pavarur që vijnë këta nga një fshat dhe do të angazhojmë kompaninë KRM "Ambienti" që t'i vejnë një apo dy kontejnerë 1.1 në pozicionet qendrore të fshatit, nëse ka kërkesë të banorëve.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, dikush tjetër?

Ragip Kryeziu: Për atë kontejner që e kërkoi, unë jam kundër, se nëse ne e gjejmë një kontejner midis rrugës, bëhet palidhje edhe vjen puna që e mbulon, e kalon situatën, po gjithkush mbeturinën e vet në shtëpi të vet, në kontejner të vetin. Përndryshe, jam i pajtimtë edhe këta kontejnerë që janë kënde, nuk kanë nevojë me qenë, se gjithkush duhet m'u marr me mbeturina të veta, e më e mira është me u vetëdijesuar me kohë se pas kohe, se nëse një njeri, fjala po bie një qytetar e pinë duhanin, nuk ka nevojë me hedh në tokë, mundet me qit në pako të veten edhe të shkojë në shtëpi të vet ta gjuaj, e jo të ma bëjë bërlllok mua, natë e ditë heq edhe s'po mund t'i dal në skaj. Po ma merr mendja se secili njeri duhet me qenë i kulturuar, me ditë çka është bërlloku, çka është pakoja e duhanit, çka është kur merr diçka me ngrënë kështu me gjuajt në kontejnerë të vetin, e jo prej ballkonit i ka ra njërit çorba në krye. Ne duhet tamam m'u marr me

këtë punë seriozisht, mos me pas bërlllok as në shkollë, as para komunës, as para një vendi tjetër po edhe në park kur të shkojmë, t'i kenë qeset me veti, me gjuajt, se kjo vaki bën veç në popullin tonë. Duhet me rrok seriozisht, mbeturinat me u vënë në shportë.

Për kompani jam i kënaqur se kompani më të fortë se e Klinës nuk ka askund në territor të Kosovës. Pra, i falënderoj shumë edhe punëtorë më të mirë, më të edukuar, më të sjellshëm nuk ka mundësi të ketë, jo që kam interes të them, por duhet thënë kur është e vërtetë, unë i nderoj shumë edhe janë duke bërë shumë edhe nëpër rrugë. Nuk mund të lëmë çdo vend kontejnerë, kontejnerët duhet me i hekë, me bërë pastër, me bërë rregull edhe gjithkush me ditë qysh me u marr me bërlllokun e vet.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit Ragip, dikush tjetër? Urdhëro i nderuar?

Nysret Berisha, zyrtar në kompaninë "Ambienti": Jam Nysret Berisha, së pari e përshëndes iniciativën e miratimit të kësaj rregullore, ka qenë e nevojshme për një kohë të gjatë kjo. Sa i përket kontejnerëve që i propozoi ai djaloshi, nuk është fort e preferuar që të vendosen ata kontejnerë, për arsye se mund të krijohen pika ilegale dhe deponi të cilat shkaktojnë probleme, si për kompani po ashtu edhe për vet qytetarët e Klinës. Desha të ndalem pak te rregullorja, unë jam zyrtar në kompaninë "Ambienti", dhe rregullorja është shumë e mirë, e specifikuar mjaft mirë, po ajo çka kërkoj nga zyrtari i Ambientit dhe drejtori i Shërbimeve Publike është që, në kuadër të kësaj rregullore të përfshihen punët të cilat mund t'i bëjë kompania jonë, që kanë të bëjnë me fshirjen, larjen, rregullimin e parqeve dhe shesheve në qytetin e Klinës, të bëjnë një marrëveshje ose një sistemim dhe t'i dorëzojë te kompania "Ambienti", e cila me kapacitetet që ka besoj që mund t'ja arrijmë, t'i përfundojmë dhe t'i kryej me sukses këto. Shpresojmë një gjë e tillë të ndodh dhe nuk kanë m'u ndarë të pakënaqur askush nga kjo, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, për këtë të fundit po të informoj se kjo veç ka ndodhur, ne veç po i presim propozimet prej drejtorisë, kanë me u shtuar edhe këto shërbime deri sa të shkojmë në seancë edhe besoj që ka me qenë pjesë e rregullores. Edhe njëherë, Driton, urdhëro?

Drilon Morina, zyrtar për tatim në pronë: Atë që e thash, po bazohem prej faktit, po flas për fshatin Qeskovë, edhe shoh gjatë rrugës që është rrugë magjistrale, marrin dhe hedhin bërlllok. Unë e thash në atë mënyrën që hyn në market, ushqehet p.sh., merr diçka edhe e ka një kontejner ku e gjuan, p.sh., me marr në veturë e sheh një pjesë ku ka male, livadhe dhe e hedh. Tash ne nuk mund të qesim kontejner shtëpiak midis livadhit ose midis fshatit, për atë arsye edhe e propozova sepse ka mundësi që dikush nuk dëshiron t'i mbaj në veturë, shumicën e rasteve e hedhin prej dritares, për këtë arsye edhe e propozuam, mendoj që është një ide që na vyen gjithëve me pas një, e jo me gjuajt p.sh., vend e pa vend, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, unë besoj që edhe Drejtoria e Shërbimeve Publike si edhe kompania janë duke i hulumtuar gjitha këto praktika edhe besoj që...Urdhëro, Idriz?

Idriz Beqiri, drejtor i kompanisë "Ambienti": Edhe njëherë, përshëndetje! Kryesues edhe për informim të opinionit, ne i kemi pasur 5-6 fshatra që ka qenë duke u kryer shërbimi me kontejnerët 1.1 metër kub, por rrethanat na kanë dhënë përvojë që të mësojmë prej tyre se ku

është i vendosur një kontejner 1.1 janë gjasa shumë të mëdha që të krijohet një deponi e vogël , mini-deponi, edhe në këtë rast është edhe ajo rrezikshmëria tjetër se edhe në atë kontejner po i jepet mundësia qytetarëve të pandërgjegjshëm të hedhin mbeturina që janë të ndaluara të jenë në atë kontejner, që në rastet konkrete po pësojmë ne si ndërmarrje, si njësi. Sepse po kemi shumë defekte të mëdha e duke ja shtuar faktin që tash kemi edhe kamionë të ri që janë të vitit të fundit, vitit të kaluar është e pamundur ne të guxojmë edhe t'i vejmë, se krijojmë një dëm shumë të madh. Te pjesa tjetër, edhe te dyqanet e këto janë të ndara në biznese, çdo biznes që është i interesuar, biznes personal e ka mundësinë të vijë te ne, të pajiset me një kontejner 1.1 , që është kontejner personal i tij, i biznesit personal që e menaxhon, që prej çfarëdo vendi ku del e ka mundësinë edhe ai të shkojë, por është me menaxhim të atij biznesi, e nëse ndodh ndonjë përgjegjësi ose ndodh se ka diçka në atë kontejner, mbeturina që nuk janë të lejueshme në përgjithësi e merr biznesin 25:08..e kur janë kontejnerët...ne, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike edhe me zyrtarë për menaxhim, jemi duke e shikuar edhe rivendosjen pak edhe të kontejnerëve brenda në qytet që i kemi, duhet me bërë eliminime ngapak të këtyre kur është mundësia që për qejf edhe me dëshirë i vendosim kontejnerët 240 litërsh te kontejnerët publik, gjithsecili objekt ku është, po s'po na krijohet mundësia të hyjmë edhe me kamion, se nuk po kemi qasje te rruga edhe për t'i kryer shërbimet, ju faleminderit.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit Idriz, po, urdhëro Dardan?

Dardan Bashota, zyrtar mjedisor: Tek mënyra e organizimit dhe riorganizimit të vendosjes së kontejnerëve dhe ofrimit të shërbimeve për rregullimin e transportit është në përgjegjësi të komunës, konkretisht të Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Unë ju falënderoj shumë për këtë pyetje, bëje një kërkesë, do ta marrim në shqyrtim, do t'i shohim të gjitha mundësitë si komunë dhe të bëhet aprovimi i asaj kërkesë me një arsyeshmëri të mirë, sepse vlera e shërbimit, grumbullimit, transportimit, të gjitha këto të vendosjes së kontejnerëve është në përgjegjësi të komandës, do të thotë bëhet me një riorganizim. Tek çështja që pyeti zotëri Nysret, te shkelja e rrugëve, trotuareve publike e këto gjëra tjera, ne, dje e kemi pasur një takim edhe me kryetarin e komunës edhe me këtë grupin punues, dhe e kemi futur në këtë rregullore fshirjen e rrugëve, trotuareve, pastrimin, larjen e rrugëve, kositjen e sipërfaqeve gjelbëruese dhe në fund e kemi edhe një nen të veçantë, ku thuhet që komuna do të bëjë marrëveshje ose kontratë me kompanitë publike, për të gjitha shërbimet të cilat janë në këtë rregullore do të bëjnë marrëveshje të veçantë. Do të thotë edhe të fshirjes edhe të larjes së rrobave edhe të gjitha të tjerave që janë pjesë përbërëse e kësaj rregullore. Faleminderit shumë!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit Dardan, dikush tjetër? Po, Vlora Tafili?

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Përshëndetje për të gjithë të nderuar të pranishëm, po mundohem t'i jap një kahje tjetër sa i përket dëgjimit, diskutimeve këtu që po bëhen. Kryesues e kam një propozim, më shumë vlen për zyrtarin për mjedis, tash nuk e di sa mund të inkluadrohet në Rregulloren e Plan-veprimit, përveç aspektit procedural dhe infrastrukturor që kompania i ka lëvdatat më pozitive për punën që e kanë bërë në terren, po a ekziston mundësia që kjo rregullore të parasheh edhe shumë fushata vetëdijesuese dhe nxitëse më kreative, dhe që do të jenë tradicionale për vetëdijesim dhe për mirëmbajtje të hapësirave përbashkëta ose p.sh., ndarja e

mirënjohjeve ose çmimeve për vendin, fshatin ose qytetin, grupin e qytetarëve më aktiv ose sa i përket individit, se më shumë që me investuar në shporta ne duhet me investuar në njerëz si Ragipi. Neve si institucione na vyen me investuar në njerëz , në këtë rast e mora Ragipin shembull, si një ambientalist aktiv që është.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, dikush tjetër? Ne e kemi edhe një dokument tjetër që është fort i lidhur me këtë të parën, urdhëro, Dardan?

Dardan Bashota, zyrtar mjedisor: Përshëndetje edhe njëherë, dëshiroj të ju përgjigjem Vlorës se pikërisht lidhur me vendin e punës që veçse ajo e ka në komunën e Klinës, te neni 27 thotë për informimin dhe promovimin, komuna e Klinës është transparente ndaj palëve të interesuara për dhënien e informatave dhe zyra përkatëse e menaxhimit të mbeturinave, në bashkëpunim me zyrën e informimit thotë: do të bëjë fushata vetëdijesuese , ligjërata publike, materiale promovuese për ngritjen e vetëdijes për menaxhimin e mbeturinave, aty thuhet se edhe organizatat e shoqërisë civile inkurajohen të përkrahin, të monitorojnë , të promovojnë dhe të informohen për menaxhimin e mbeturinave.

Pra, neni 27 në rregullore ka të bëjë me informim dhe promovim.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit Dardan, dikush tjetër? Unë po besoj se i kemi marr krejt këto çka biseduam edhe nëse më lejoni ne kishim kaluar në dokumentin e dytë, që nuk është hiç më pak i rëndësishëm, është:

Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave- për këtë unë e kisha lutur Dardanin ta bëjë një prezantim të shkurtër dhe pastaj kishim hapur debat, urdhëro Dardan?

Dardan Bashota, zyrtar mjedisor: Faleminderit, Plani komunal për menaxhim të mbeturinave 2023-2027 është një dokument i planifikimit i cili po ashtu bazën e ka në Ligjin e Mbeturinave dhe ligjeve tjera që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Ky plan është në përputhshmëri të plotë me strategjinë kombëtare të menaxhimit të mbeturinave dhe në këtë plan parashihen nevoja financiare, burimet e financimit, kornizën e aplikuesve të financimit dhe në këtë plan është versioni i komunës, misioni i komunës, masat për rritjen e cilësisë në mbrojtjen e mjedisit, konkretisht në grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave. Në këtë plan përshkruhet gjendja ekzistuese në komunën tonë, resurseve natyrore , gjendja e mjedisit, biodiversiteti, gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave, konkretisht të menaxhimit të mbeturinave aty parasheh, janë të përshkruara shumë çartë edhe kompania e ambientit qysh operon, me sa punëtorë, me çfarë makinerie, me gjëra tjera të cilat i ka në menaxhim kompania, pastaj janë objektivat, pastaj ka të bëjë me, riorganizimin e shërbimeve që e folëm deri më tani, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave. Pra, në këtë plan synojmë që të kemi një shërbim më të qëndrueshëm dhe më efikas në grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, përmirësimin e efikasitetit për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave. Marrjen, komanda parasheh që në periudhë të shkurtër kohore, që të merr përsipër edhe imaturimin dhe inkasimin e mbeturinave dhe që të kemi një përforsim të kontrollit në shërbim të menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë. Në pika të shkurtra ishte një përmbledhje se çka parasheh ky plan, faleminderit shumë!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, Dardan! Po hap debat rreth planit, a ka dikush, po urdhëro,

Drilon?

Drilon Morina, zyrtar për tatim në pronë: Përshëndetje, u përmend riciklimi, a është paraparë në rregullore që në kontejnerë të veçantë me u gjuajt deponia ose me u ndarë? Për shembull, ne e kemi riciklimi ku bëhet në qese ose me kanta të plastikës ose me qelqe. A është paraparë me u bërë ndarja e kontejnerëve për këto mbeturina të veçanta, e jo me u ndarë pasi të hidhen? Faleminderit.

Dardan Bashota, zyrtar mjedisor: Plani e specifikon shumë qartë, bile-bile thuhet në një pjesë të planit që të veprohet edhe ndërtimi i një oborri riciklues si pilot-projekt i cili do të bëhet diku në ndonjë shkollë apo ndonjë fshat të caktuar, që të kemi si pilot-projekt. Ne, aktualisht nga GIZI gjerman, përmes grandit të performancës të mjedisit të pastër kemi përfituar edhe disa komposterë dhe së shpejti do të fillojmë edhe shpërndarjen e tyre, do të bëjmë edhe një fushatë vetëdijesimi se si do të bëhet përdorimi i atyre komposterëve dhe do të fillojmë së pari me komposterë pastaj me kontejnerë tjerë që janë riciklues, që do të përdoren nga qytetarët. Së pari do të jetë kompostimi, të shohim si do të shkojë kjo procedurë, pastaj do të fillojmë me kontejnerë të veçantë që të bëjmë riciklimin e këtyre, parashihen në plan të gjitha.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit Dardan, dikush tjetër? A kemi të interesuar me na ndihmuar, unë jam i obliguar edhe njëherë me ju pyet, a ka dikush? Ju informoj edhe njëherë, edhe nesër edhe pasnesër, ne ende jemi nëpër shqyrtime, kujtdo që ju kujtohet diçka, unë i dhashë rrugë të mundshme ku mund t'i qasemi akoma ndryshimeve edhe nëse janë edhe të rëndësishme edhe të arsyeshme mirë. Unë besoj se të gjithë akterët institucional i marrin për bazë edhe janë pjesë e dokumenteve tona të përbashkëta.

Unë po ju falënderoj shumë për pjesëmarrje, duke shpresuar që gjithmonë do të jemi bashkëpunues në mbrojtje të atyre që po thotë edhe Ragipi, me kërkesë se ambienti është i yni, jetën ne e bëjmë në të dhe krejt këta punëtorë janë familjarë tanë, janë njerëz tanë. Prandaj të gjithë jemi të mundshëm me kontribuar, me ruajt pastërtinë tonë edhe me i ndihmuar edhe kompanisë, edhe zyrtarëve, edhe punëtorëve që janë aty, faleminderit shumë për pjesëmarrje!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi



KRYESUESI,
Fadil Gashi

